



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**

**Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës**

*Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage / Ministry for the Kosova Security Force*

**Departamenti i Personelit/ Odsek za personal/Department for Personnel**



Në mbështetje të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 03/L-045 për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ligjin Nr. 03/L-82 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, Rregulloren Nr. 03/2018 për Zhvillimin e Karrierës së Pjesëtarëve të FSK-së, neni 18 i kësaj Rregulloreje, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës shpall:

**K O N K U R S I B R E N D S H E M**  
**PËR GRADIM NGA GRADA E NËNOFICERIT NE GRADËN E OFICERIT**

Grada; OF1 Nëntoger/Toger  
Numri i postit; BMO 865  
Detyra; Pilot  
Njësia; Kompania e Aviacionit/BMO

**Gradimi;**

Gradimi i pjesëtarëve të FSK-së është një proces i cili do të jetë i bazuar në nevojat e Forcës (pozitat e lira), si dhe me qëllimin e përzgjedhjes së pjesëtarëve më të kualifikuar nëpërmjet një procesi të drejtë dhe konkurrues.

**Të drejtat individuale të personelit të FSK-së:**

Pjesëtarëve të FSK-së u ofrohet trajtim i drejtë dhe i barabartë pavarësisht nga gjinia ose etnia, mundësi për të pasur karrierë të plotë për të realizuar plotësisht potencialin e tyre përmes praktikës së emërimit, ngritje në detyrë dhe zhvillim në bazë një sistemi të përgjithshëm të meritave dhe transparencës, ku çmohen e respektohen si individë dhe mbështeten e shpërblehen sipas rregullave dhe kushteve për shërbim.

**Kriteret për gradim;**

- Të mos jetë më i/e vjetër se 36 vjeç;
- Të ketë të përfunduara Studimet Universitare Ushtarake (QSU apo Akademiti të tjera partnere me program ushtarak së paku prej 12 muajve) apo Studimet Universitare Civile (niveli bachelor);
- Të mos jetë i ndëshkuar sipas Kodit Disiplinor për ndalim gradim në kohën e shqyrtimit për emërim dhe gradim;
- Të jetë me gradë OR-5 (Rreshter) apo OR-7 (Kapter);
- Të ketë nivelin e duhur të përgatitjes fizike;
- Të ketë nivelin e duhur të ekzaminimit mjekësor;
- Të ketë nivelin e kërkuar të verifikimit për ato pozita që kërkohet sipas listës së miratuar nga autoriteti përkatës në MFSK
- Performanca e Vlerësimeve Vjetore të përmbushjes së detyrës përfshirë rekomandimet për avancim për vitet në shërbim.

### **Gradimi i kandidatit/nënoficerit të përzgjedhur;**

Kandidatët (nënoficerët në gradën OR-5 dhe OR-7) e përzgjedhur nga Bordi për Emërimet dhe Gradime, do të gradohen në gradën e parë të oficerit (Nëntoger, OF-1\*) vetëm pas përfundimit me sukses të Kursit Bazik për Oficer.

Në rast se kandidatët (nënoficerët në gradën OR-5 dhe OR-7) e përzgjedhur nga Bordi për Emërimet dhe Gradime nuk e përfundojnë Kursin Bazik për Oficer, atëherë ata nuk do të gradohen dhe si rezultat i kësaj do të kthehen në pozitën paraprake ose pozita të lira të barasvlershme me gradën e tyre paraprake.

### **Afati i aplikimit;**

Konkursi është i hapur nga data 31.08.2018 deri më datën 07.09.2018.

### **Si të aplikoni;**

Kandidatët (Nënoficerët) duhet të aplikojnë për gradim në gradën e parë të oficerit (Nëntoger, OF-1\*) sipas shtojcës 6 dhe duhet të kenë të plotësuar formularin (sipas shtojcës 6A) nga eprori i parë vlerësues i njësisë organizative (minimum me gradë kapiteni) në pajtim me Rregullorën Nr. 03/2018 Zhvillimin e Karrierës së Pjesëtarëve të FSK-së.

Kandidatët mund t'ia bashkëngjisin kërkesës së tyre kopjet e dokumenteve/certifikatave/diplomave të cilat i kanë marrë së fundi e që nuk janë evidentuar ende në dosjen e tyre personale.

Formularët e aplikimit për gradim janë në dispozicion në të gjitha njësitë, përkatësisht në Zyrat e Personelit, ku gjendet shpallja e konkursit. Formularët duhet të dorëzohen personalisht, pranë Zyrave e personelit të njësisë përkatëse të FSK-së, në çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim.

Për informata plotësuese, mund të kontaktoni zyrat e personelit.

**Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës ofron trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët (nënoficerët në gradën OR-5 dhe OR-7) të cilët konkurrojnë sipas konkursit, dhe mirëpret aplikacionet e tyre për gradim në gradën e oficerit (Nëntogerit) pa dallim nga përkatësia etnike apo gjinore.**